

FATMIRA MUSAJ

**KONTRIBUTI I BAJRAM CURRIT NË LËVIZJEN
DEMOKRATIKE TË VITIT 1924***

Bajram Curri është një ndër figurat e spikatura të historisë sonë kombëtare i cili me veprimtarinë e tij të pasur e të gjithanshme kontribuoi në momente të rëndësishme të historisë së popullit tonë, në luftë për pavarësi dhe shtet kombëtar, për konsolidimin e tij, vendosjen e një rendi demokratik si dhe në përpjekjet për mbrojtjen e të drejtave të shqiptarëve dhe organizimin e një lufte çlirimtare në viset e aneksuara nga shtetet fqinje.

Në këtë kumtesë do të ndalemi dhe të pasqyrojmë rolin e tij në lëvizjen demokratike të qershorit të vitit 1924, vit i cili u karakterizua me ngjarje të rëndësishme që sollën ndryshime në planin politik të vendit. Përpara se të trajtojmë rolin që luajti ai në këtë lëvizje duhet të pasqyrojmë veprimtarinë e tij pas kthimit në Shqipëri në fillim të vitit 1920, ftohja me Ahmet Zogun dhe pozicionimi në krahun e opozitës demokratike.

Për kontributin e dhënë në luftë për pavarësi në vitin 1920, qeveria e emëroi B. Currin në Prefekturën e Kosovës, në shërbimin ushtarak, duke i dhënë gradën kolonel. Ky pozicion do t'i krijonte mundësi që krahas ndihmesës në konsolidimin e shtetit shqiptar të ndiqte në të njëjtën kohë nga afër gjendjen e shqiptarëve të Kosovës.

Çështja e Kosovës dhe e trevave të tjera shqiptare në Jugosllavi ishin shumë të rëndësishme për të. Për këtë, theksonte S.Vllamasi “ka qenë irredent i tmerrshëm, pse e donte shumë Kosovën, aq sa nuk pranonte asnjë arsytim në lidhje me metodat dhe hollsinat e politikës irredente”¹. Veçanërisht përpjekjet për të organizuar lëvizjen çlirimtare në zonat e pushtuara dhe bashkimin me shtetin amë nuk kishin dhënë rezultatet e duhura. Përkundrazi, lëvizjet e shqiptarëve pas vitit 1913 kishin sjellë një kundërveprim të pamëshirshëm të Beogradit ndaj popullsisë së këtyre zonave të cilat u shoqëruan me djegje, vrasje dhe dëbime të popullsisë shqiptare. Në të njëjtën kohë shteti shqiptar, në

* Kumtesë e mbajtur në Konferencën Shkencore “Rreth prolemeve të debatueshme të lëvizjes së Qershorit 1924”, organizuar në Gjakovë, qershor 2004.

¹ Sejfi Vllamasi, *Ballafaqime politike në Shqipëri (1897-1942)*, Tiranë: “Marin Barleti”, 1995, f. 137.

gjendjen e vështirë në të cilën ndodhej, përveç mbështetjes morale dhe territoriale nuk mundi t'i ofronte më tepër kësaj lëvizjeje. Një politikë e tillë e ndjekur nga Komiteti MKK kishte influencuar dhe në marrëdhëniet midis dy shteteve, të cilat ishin në tension të vazhdueshëm. Autoritetet e Beogradit në forume ndërkombëtare do të akuzonin shtetin shqiptar, si drejtues të lëvizjes irredentiste e cila në bashkëpunim me çetat bullgaro-maqedone kërkonte ndryshimin e kufijve të shtetit jugosllav.

Në situatën e vështirë politike të krijuar për shtetin shqiptar gjatë dhe pas Luftës së Parë Botërore, kur rrezikohej qenia e tij si shtet, në gjirin e politikanëve të kohës, si Sulejman Delvina, Ahmet Zogu, Sejfi Vllamasi etj., u argumentua se në këtë moment të vështirë për shtetin shqiptar, lëvizja irredentiste e krerëve kosovarë për zgjidhjen e çështjes së Kosovës dhe trevave të tjera shqiptare në Jugosllavi nëpërmjet organizimit të lëvizjes së armatosur u konsiderua si një mjet joefikas. Ato gjykuan se me çlirimin e vendit dhe konsolidimin e shtetit shqiptar, çështja e lirive dhe të drejtave të shqiptarëve në Jugosllavi, duhej të ngrihej dhe mbrohej në rrugë institucionale.

Një nga drejtimet kryesore të politikës së jashtme të shtetit në periudhën e viteve 20-të, ka qenë normalizimi i marrëdhënieve me shtetet fqinje pra edhe me Jugosllavinë gjë që do të ndikonte në stabilizimin e jetës së vendit dhe në zhvillimin e tij. Tani shteti shqiptar kishte mundësi edhe si anëtar i Lidhjes së Kombeve, që në një forum të tillë të ngrinte fuqishëm zërin, në mbrojtje të të drejtave dhe lirive të popullit shqiptar të Kosovës dhe trevave të tjera, si dhe do të denonconte politikën antishqiptare të shteteve fqinje ndaj tyre. Por B. Curri dhe politikanët kosovarë nuk e pranuan një arsyetim të tillë. Ato synonin që përpjekjet për stabilizimin e shtetit të mos i ndanin nga ato për çlirimin e Kosovës dhe trevave të tjera shqiptare dhe i qëndruan deri në fund idesë së tyre. Kjo çoi në ashpërsimin e marrëdhënieve të tyre me A. Zogun, autoriteti i të cilit në qeverisjen e vendit në vitet 20-të do të rritej së tepërmi.

Forcimi i autoritetit të A. Zogut në pozitën e ministrit të punëve të Brendshme në qeverinë Ypi dhe masat që mori në vendosjen e rendit, kundër anarkisë, forcimin e pozitave të organeve shtetërore, përfshirë edhe goditjen e kundërshtarëve politikë, e shqetësoi tepër grupin liberal-demokrat. Ata me anë të luftës parlamentare ngritën kërkesën për thirrjen e një Asambleje Kushtetuese e cila, të miratonte ligjin themeltar të shtetit, ku të bëheshin ndryshime të tilla në organet e larta të shtetit, si vendosja përfundimtare e formës së regjimit që të bëhej i mundur

zhvillimi demokratik i vendit. Mirëpo B. Curri dhe veprimtarë të tjerë të Komitetit MKK, bashkë me figura të tjera politike të pakënaqur dhe të goditur nga A. Zogu, u pajtuan me kërkesën e opozitës, po ndryshe nga kjo synuan të realizonin atë me anë të forcës duke përmbysur qeverinë . Ai në bashkëpunim me H. Prishtinën, Aqif Pashën, Hamit Toptanin e Elez Isufin organizuan lëvizjen e marsit 1922. B. Curri në krye të 2000 malësorëve iu drejtua Shkodrës. Ato ditë, kryeministri, me anë të një telegrami informohej për planin dhe qëllimet e lëvizjes së B. Currit. Ai me të mbërritur në Vaun e Dejës, do t'i kërkonte qeverisë të mblidhte Asamblenë Kushtetuese dhe se “kishte theksue se nuk ka me kërkuë me e da çështjen me luftë të brendshme”². Duhej që qeveria të plotësonte paqësisht këtë kërkesë. Sulmi i kryengritësve në drejtim të Tiranës e vuri qeverinë në vështirësi serioze por nuk arriti ta përmbysë atë.

B. Curri, H. Prishtina, H. Curri etj., duke e konsideruar A. Zogun si filoserb dhe pengesë në rrugën e zgjidhjes së çështjes së Kosovës, organizuan në janar 1923 në Prefekturën e Kosovës një goditje të re kundër qeverisë e cila nuk pati një fund më të mirë se ajo e marsit 1922³.

Lëvizja e B. Currit dhe e organizatorëve të tjerë e shtoi zemërimin e A. Zogut. Veçanërisht veprimin e B. Currit, tashmë oficer me gradën kolonel e trajtoi si shkelje të disiplinës dhe ligjeve të ushtrisë dhe e konsideroi atë si të paligjshëm. Me propozimin e tij, Këshilli i Ministrave në mars të vitit 1922 vendosi ta degradonte B. Currit⁴. A. Zogu nuk u mjaftua me kaq. Duke e konsideruar atë si një rrezik për qeverinë e stabilizimin e vendit kërkoi që të merreshin të gjitha masat për të shtypur çdo lëvizje të B. Currit dhe bashkë me shokët e tij, t'i jepeshin drejtësisë.⁵ Gjyqi ushtarak e dënoi atë me vdekje⁶.

Tashmë në pozitë edhe të kryeministrit, qenia e lirë e B. Currit e mbështetësve të tij, do të mbetej shqetësim për qeverisjen e vendit në këtë periudhë. Qëndrimi kundër lëvizjes irredentiste brenda vendit si dhe

² Arkivi Qendror Shtetëror i Republikës së Shqipërisë (më tej: AQSh), Fondi 2, dos.1, dok.8. Shih në: *Dokumente e materiale historike nga lufta e popullit shqiptar për liri e demokraci (1917-1941)*, botim i Drejtorisë së Arkivave Shtetërore të RPSH, Tiranë: 1959, f. 112.

³ *Historia e Popullit Shqiptar*, vëll. III, Akademia e Shkencave e Republikës së Shqipërisë, Instituti i Historisë, Tiranë: “Toena”, 2007, f. 186.

⁴ AQSh, Fondi 2, dos. 1, dok. 121, Shih në: *Dokumente e materiale historike ...*, f. 113.

⁵ *Po aty*, f. 115.

⁶ *Po aty*, f. 116.

ndaj çdo bashkëpunimi të saj me lëvizje të kësaj natyre jashtë tij, A. Zogu e konsideroi si pengesë në stabilizimin e vendit. Përpjekja për eliminimin e saj, përbënte edhe një nga detyrat e programit të qeverisë në janar të vitit 1923. Këtë qëndrim të tij A.Zogu do ta nënvizonte në intervistën e dhënë gazetës “Shqipëria e Re” në prill të këtij viti⁷.

Me gjithë pozicionimin kundër A. Zogut ndaj idesë së rrugës së armatosur si mjet për zgjidhjen e çështjes së Kosovës të zgjedhur nga B. Curri, H. Prishtina etj., çështja e Kosovës dhe trevave të mbetura jashtë kufijve politikë të shtetit shqiptar si dhe politika antishqiptare e shteteve fqinje ndaj tyre, do të përbënte një çështje me rëndësi në politikën e jashtme të shtetit shqiptar. Ajo herë pas here do të zinte vend në bisedimet parlamentare ku denoncohej politika e Beogradit ndaj shqiptarëve. Me anë të telegrameve dhe përfaqësuesve të saj në Lidhjen e Kombeve qeveria ngriti zërin në mbrojtje të të drejtave dhe lirive të saj.

Qëndrimi ekstrem i A. Zogut dhe qeverisë që ai kryesonte, deri në dënimin me vdekje të B. Currit, H. Toptanit etj., u bë objekt diskutimi në një nga seancat parlamentare të muajit maj 1923⁸. Deputetët e opozitës kërkuan që në listën e të amnistuarve, të faleshin edhe B. Curri, H. Toptani, I. Kuçi etj. Sipas tyre ata e meritonin sepse kishin dhënë aq shumë për kombin⁹. Me ndërhyrjet e tij të herëpashershme, A. Zogu nuk bëri asnjë tërheqje në vendimet e tij. Ai e argumentoi qëndrimin e tij me atë se B. Curri etj., me lëvizjet e tyre kishin shkelur ligjet e shtetit dhe kishin çuar vendin drejt destabilizimit. Prandaj ai do të mbyllte diskutimin e tij me fjalët “Ne jemi të barabartë para ligjit dhe të gjithë duhet t’i bindemi atij, do të kërkoj zbatimin e ligjit për këdo që e shkel atë pa dallim”¹⁰. Deputetët e opozitës e akuzuan A. Zogun se me këtë qëndrim ai kërkonte të eliminonte figura me reputacion dhe mbështetje në popull sepse i shihte si pengesë në realizimin e planeve të tij politike dhe synonte të linte Shqipërinë në dorën e një njeriu (d.m.th. të A.Zogut).¹¹

Dënimet, ndjekjet ndaj tij nuk arritën ta bindnin B. Currin për të hequr dorë nga lëvizja irredentiste. Përkundrazi në gjirin e malësorëve të Veriut ku gjeti strehë dhe mbrojtje ai do të mbështeste çdo lëvizje të tyre

⁷ *Shqipëria e Re*, prill, 1923, f. 1.

⁸ *Bisedimet e Këshillit Kombëtar*, Tiranë: 1923, f. 1616.

⁹ *Po aty*.

¹⁰ *Po aty*.

¹¹ *Po aty*.

për përmirësimin e qeverisjes së vendit dhe do të rriste aktivitetin me Komitetin “Mbrojtja Kombëtare e Kosovës”, në mbrojtje të të drejtave të shqiptarëve në Jugosllavi.

Në një sërë dokumentesh dëshmohet se gjatë vitit 1923, B. Curri, tashmë në arrati në Malësitë e Veriut, me anë të një rrjeti të gjerë informatorësh, në krahina të ndryshme, mbante lidhje me politikanë opozitarë si dhe njoftohej për situatën politike të krijuar në vend dhe veçanërisht për veprimtarinë e opozitës e cila në parlament dhe jashtë tij kërkonte thirrjen e një Asambleje Kushtetuese për të përcaktuar formën e regjimit dhe organet më të larta të shtetit, në mënyrë që të garantohej vazhdimi i demokratizimit të vendit. Gjithashtu informohej edhe për masat që A. Zogu po merrte duke përdorur të gjitha mjetet për të mbrojtur qeverisjen e vendit.

Qysh në shkurt të vitit 1923, B. Curri, duke u nisur edhe nga gjendja e vështirë e malësorëve, nisi organizimet për një lëvizje të armatosur antiqeveritare, e cila do të intensifikohet në gjysmën e parë të vitit 1924, kur në radhët e opozitës ende nuk qarkullonte një mendim i tillë. Për të siguruar edhe mbështetjen e politikanëve në Tiranë në fillim të vitit 1924, i shkruante Hoxha Kadriut një letër ku shprehte gatishmërinë e popullit të atyre anëve për t’i dalë zot vendit “Përpiquni me sa fuqi të kini me të gjithë shokët e të bini në favor për plotësimin e dëshirave të popullit”¹².

Rrokullisja e ngjarjeve në parlament dhe jashtë tij, ndezën situatën politike kundër qeverisë e cila arriti kulmin më 20 prill kur plagoset për vdekje, nga njerëz të A. Zogut, Avni Rustemi, një nga figurat e rëndësishme të opozitës demokratike në Shqipëri. Vdekja e tij, tronditi tërë vendin. Ajo u prit me indinjatë edhe nga B. Curri dhe populli i prefekturës së Kosovës, i cili e kishte përfaqësuesin e saj në Këshillin Kombëtar. Të gjitha bateritë për vrasjen e A. Rustemit u shkarkuan mbi A. Zogun. Ky veprim i tij, solli një stuhi të paparashikuar në tërë vendin. U paralizua jeta politike, u thellua kriza ekonomike, e cila rriti ndjeshëm pakënaqësinë në shtresa të ndryshme të popullsisë. Refuzimi i qeverisë për plotësimin e kërkesave të forcave opozitare për dorëheqje, si dhe mospranimi nga opozita i thirrjeve të qeverisë për bisedime dhe kompromis, e shtyri opozitën drejt vendimit për organizimin e lëvizjes së armatosur për të përmbysur qeverinë e dalë nga zgjedhjet e vitit 1923.

¹² *Bajram Curri, Trajtesa e Dokumente*, Akademia e Shkencave e Republikës së Shqipërisë, Instituti i Historisë, Tiranë: “Shtypshkronja e Re”, 1982, f. 181.

Një nga mbështetësit kryesorë të kësaj lëvizje në Veri të vendit ishte Bajram Curri. Përveç popullsisë së Nikaj-Mërturit, Krasniqes, mbështetje i ofruan atij edhe malësorë të Pukës, Shalës, krahina e Hasit e Lumës etj. Grupe të armatosura të vendosura nën komandën e tij, kishin nisur sulmet sporadike kundër organeve lokale qeveritare. Thirrja për kryengritje të armatosur që shoqëria “Bashkimi” i bënte në 5 maj djalërisë shqiptare, gjeti një truall të përgatitur. Tashmë në të gjithë vendin opozita i hyri punës për organizimin e kryengritjes dhe për të bërë për vete edhe ushtrinë. Reparte të tëra anë e mbanë vendit, u bashkuan me kryengritjen.

Më 26 maj B. Currit i vjen një letër nga Shkodra, me anë të së cilës i bëhej me dije se kryengritja ka përfshirë tërë Shqipërinë. Me gjithë masat që mori qeveria për uljen e tensionit, nuk mundën të mënjanonin krizën e thellë ekonomike dhe politike që kishte përfshirë vendin. Autoriteti i saj kishte rënë aq shumë sa sipas dokumenteve “ajo asht si mos me qenë, mbasi nuk është tu e njoftë kurrkush”.¹³

Po atë ditë, forcat e B. Currit morën Krumën, larguan zv/prefektin, zv.qark/komandantin dhe u nisën për në Lumë¹⁴. Edhe në këto momente tepër kritike, A. Zogu nuk rreshti përpjekjet për të organizuar forcat e armatosura për t’iu kundërpërgjigjur kryengritjes së armatosur. I emëruar nga Këshilli i Naltë, komandant i operacionit mundi të vinte në gadishmëri një ushtri prej 12.000 vetë.

Beogradi ishte i interesuar për shtypjen e kryengritjes dhe eliminimin e opozitës demokratike sepse qëndrimi A.Zogut kundër lëvizjes irredentiste i siguronte qetësi në kufirin me Shqipërinë i cili kishte qenë shumë problematik për ta. Kështu ata bënë përpjekje për t’i ardhë në ndihmë Ahmet Zogut, nëpërmjet Ceno beg Kryeziut dhe mbështetësve të tij. Për të ulur sadopak hovin e kryengritjes antiqeveritare në pjesën veriore të Shqipërisë dhe për të tërhequr vëmendjen e saj nga objektivi kryesor, qarqet e Beogradit, përhapën lajmin për një sulm të mundshëm jugosllav për të pushtuar Shkodrën¹⁵. E gjithë strategjia e ndjekur nga Beogradi, në mbështetje të Ahmet Zogut, ishte theksuar në fjalën e ministrit jugosllav Ninçiq, qysh në dhjetor të vitit 1923, në të cilën ai deklaronte se “është në interes të shtetit serbo-

¹³ *Dokumente e materiale historike ...*, f. 144.

¹⁴ *Po aty*.

¹⁵ *Po aty*, f. 123.

kroato-sllloven, të shohë Shqipërinë fituese mbi vështirësitë e shkaktuara nga regjimi parlamentar”¹⁶.

Me gjithë manovrimet e përdorura nga A. Zogu, përkrahësit e tij brenda dhe jashtë nuk ia dolën të pengonin kryengritësit. Bajram Curri, u caktua nga Komisioni kryengritës si udhëheqës i veprimeve luftarake në prefekturat e Kosovës e të Dibrës. Ai pasi u ndesh me forcat qeveritare në Lumë, Bytyç e Kala e Dodës, i shpërndau ato dhe nisi marshimin drejt Dibrës e Matit. Krahas sukseseve të kryengritësve, nën udhëheqjen e B. Currit në Veri, nisën të vepronin edhe garnizonet më të rëndësishme të vendit si në Shkodër, Përmet, Vlorë etj. Tashmë kryengritësit po i afroreshin Tiranës.

Në vëllimin me dokumente arkivore, që flasin për drejtimin e operacionit të Veriut nga Ahmet Zogu vërehet një interesim i tij veçanërisht për B. Currit dhe fuqitë që ai drejtonte. Në telegramet drejtuar pushtetit lokal, komandave të reparteve ushtarake dhe të xhandarmërisë, ai kërkonte informacione të vazhdueshme lidhur me lëvizjet e Bajram Currit dhe forcave të tij, zonat ku ai kalonte dhe veçanërisht për vendndodhjen duke u kërkuar eliminimin e tij. A. Zogu ndiqte zhvillimin e situatës operacionale, i vlerësonte dhe në përputhje me to merrte vendime. Kur ai e pa qartë se forcat qeveritare nuk mundnin të përballonin kryengritësit për të evituar gjakderdhjen, vendosi të hiqte dorë nga rezistenca e mëtejshme e të largohej jashtë kufijve shtetërorë, drejt Jugosllavisë. Bajram Curri në krye të lumjanë dhe të dibranëve më 28 qershor hyri në Tiranë, i pritur me entuziazëm nga mijëra njerëz të kryeqytetit dhe Këshilli i Ministrave¹⁷.

Më 3 korrik, Bashkia e Vlorës duke vlerësuar kontributin e Bajram Currit në lëvizjen demokratike, i bëri ftesë të vizitonte Vlorën. Më 26 korrik qyteti i Vlorës i stolitur me flamurë priti B. Currit, i cili i shoqëruar nga autoritetet vendore u përkul me nderim dhe vendosi një kurorë me lule në varrin e Avni Rustemit dhe Ismail Qemalit.

Me gjithë kontributin e dhënë në lëvizjen demokratike të vitit 1924, B. Currit nuk iu dha ndonjë funksion në qeverinë e F. Nolit dhe ai nuk nguli këmbë. Këtë me sa duket e pranoi për të moskompromentuar qeverinë dhe për të qenë i lirë në kauzën e tij. “U hoq mënjane duke e lënë qeverisjen e vendit në duart e njerëzve të ditur. Këtë fakt, Faik

¹⁶ *Po aty.*

¹⁷ *Bajram Curri, Trajtesa ...*, f. 190.

Konica, e cilësonte si një virtyt të tij që po ta merrnin si shembull edhe të tjerë njerëz të partisë si ai, sot mund të kishim një Shqipëri tjetër shumë më të ndryshme se kjo që kemi përpara”¹⁸.

Ai përsëri nuk e ndërpreu aktivitetin në shërbim të atdheut. Në gusht të vitit 1924 bashkë me Nolin, H. Prishtinën, Gurakuqin u nis për në Gjenevë, për të marrë pjesë në punimet e Sesionit të V të Lidhjes së Kombeve, për të mbrojtur interesat e shtetit shqiptar dhe të Kosovës. Së bashku me H. Prishtinën dhe anëtarë të tjerë të KMKK, i paraqitën Lidhjes së Kombeve, qeverisë franceze dhe asaj angleze një memorandum mbi “Të drejtat e shqiptarëve dhe kufijtë e tyre natyralë (etnik)”¹⁹. Në këtë memorandum, shprehej protesta kundër politikës së ndjekur nga Shteti Serbo-Kroato-Slloven ndaj shqiptarëve i cili ka arritur deri aty sa t’u mohonte të drejtat për të jetuar²⁰.

Pas kthimit në atdhe, Bajram Curri u kthye në prefekturën e Krumës, për të ndjekur më nga afër zhvillimet në Kosovë dhe për të ndihmuar lëvizjen kaçake. Herë pas here krerë të lëvizjes çlirimtare të Kosovës, merrnin takime me të dhe e informonin për gjendjen në Kosovë dhe merrnin udhëzime për koordinimin e veprimeve luftarake.

Populli i prefekturës së Kosovës e priti me gëzim kthimin e tij. Në takime të drejtpërdrejta dhe me anë të letrave e informonin Bajram Currin për gjendjen e rëndë të krijuar në krahinë për shkak të gjallërimit të elementëve prozogistë. Të njëjtin shqetësim dhe për mosveprimin e qeverisë ndaj tyre, B. Curri ia bëri me dije dhe Elez Isufi.

Kur A. Zogu në krye të mbështetësve të tij dhe forcave vrangeliste sulmoi nga Jugosllavia Shqipërinë, B. Curri mori masa dhe organizoi qëndresën ndaj tyre. Me forcat ushtarake që ishin grumbulluar në Va Spas dhe me vullnetarët e krahinës, çliroi Krumën, Kukësin, Tropojën dhe tërë prefekturën e Kosovës. Për këtë veprim, M PB më 19 dhjetor i dërgon një telegram ku e falënderonte dhe inkurajonte për shërbimin që i kishte bërë atdheut²¹.

Ndërkohë që B. Curri, Elez Isufi etj., me të gjitha forcat ishin vënë në mbrojtje të qeverisë demokratike, A. Zogu depërtoi nga Peshkopia dhe me 24 dhjetor hyri në Tiranë. Pas rikthimit në pushtet A. Zogu krahas

¹⁸ *Dielli*, nr. 2849 (392) 11 prill 1925, f. 82.

¹⁹ *Hasan Prishtina, Dokumente*, përgatitur nga Kujtim Nuro e Nezir Bata, Tiranë: “8 Nëntori”, 1982, f. 162.

²⁰ *Po aty*.

²¹ *Bajram Curri, Trajtesa ...*, f. 198.

veprimeve që mori në drejtim të legjitimitetit të qeverisje dhe të ngritjes së institucioneve të vendit, do të angazhohej në marrjen e masave për neutralizimin e veprimeve politike të figurave që ai i konsideronte të rrezikshëm për pushtetin. Kështu menjëherë i drejtori sytë te Bajram Curri, që sipas të dhënave që kishte po bënte përgatitje për një kryengritje të re²².

Në këtë situatë A. Zogu nëpërmjet njerëzve të tij i propozoi të dorëzohej ose të largohej nga vendi²³. B. Curri i hodhi poshtë ato dhe qëndroi në prefekturën e Kosovës. Atëherë Zogu në janar të vitit 1925, ndërmoi një operacion ushtarak, të kryesuar nga Ceno Kryeziu në zonën e Krasniqes dhe urdhëroi “Të zihet gjall a vdekur B. Curri dhe të shkatërrohen fuqitë e tij”²⁴. Pas tre muajve ndjekje nga forcat e xhandarmërisë, Ceno Bej më 29 mars arriti ta likuidonte B. Currin dhe bashkëlufëtaret e tij.²⁵

Zv/Ministri i Punëve të Brendshme Kostaq Kotta i dërgoi një telegram Prefektit të Kosovës ku e falënderonte për kujdesin dhe aktivitetin që kishte treguar në vrasjen e B. Currit²⁶. Në këtë mënyrë A. Zogu eliminoi një nga kundërshtarët e tij më të vendosur dhe njëkohësisht përmbushi kërkesën e Beogradit për të mos pranuar në Shqipëri kosovarët dhe elementë të tjerë, që njihen ose dyshohen për ndjenjat e tyre si kundërshtarë të politikës jugosllave²⁷. Gazeta “Vreme” e Beogradit njoftonte se: “Me vdekjen e A. Bejtes në Drenicë dhe B. Currit në Krasniqe kaçakët mbetën pa krye”²⁸. Ndërsa gazeta “Politika” e asaj dite mortore do të theksonte: “Bajram Curri mbaroj si turbulluesi e si ma i madhi kriminel”.

Faik Konica në shkrimin kushtuar kësaj ngjarje theksonte: “Vdekja e tij më hidhëroi si një zi personale, humbja për Shqipërinë ishte e rëndë”²⁹.

²² AQSh, Fondi 152, viti 1925, dos. 9, fl. 1.

²³ Po aty, dos. 799, fl. 12-14; Gazeta *Politika*, Beograd, nr. 6096, 13 prill 1925.

²⁴ AQSh, Fondi 152, viti 1925, dos. 9, fl. 129.

²⁵ Po aty, dos. 799, fl. 13.

²⁶ Po aty, dos. 80, fl. 1-2; Fondi 152, dos. 187/1, viti 1926, fl. 166.

²⁷ Marenglen Verli, *Kosova në fokusin e historisë*, Tiranë: “BOTIMPEX”, 2000, f. 181.

²⁸ AQSh, Fondi 151, viti 1925, dos. 27, fl. 24.

²⁹ *Dielli*, 2846 (389) 7 prill 1925, fl. 2.

